

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 21/2012
Prishtinë
17 korrik 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK), më 17 korrik 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme mbajti seancë në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarit të EULEX-it Francesco Florit si dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta, Marije Ademi dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit

dhe me zyrtarin ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Prokurores publike të EULEX-it Judith Eva Tatraj, nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPSHK)

Avokatit mbrojtës M.H. për të pandehurin Sh.K.;

Përfaqësuesit ligjor, avokatit F.B. për palën e dëmtuar B.O.

Në lëndën penale me numër AP-KZ 21/2012 kundër të pandehurit:

Sh.K., me nofkën 'xxx' emri i babait xxx, mbiemri i vajzërisë nënës xxx, i lindur më xxx në fshatin xxx, Komuna Skenderaj në Kosovë, me vendbanim të përhershëm në xxx, shqiptar i Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, xxx, i pamartuar, xxx, me profesion xxx, ish xxx, i dënuar në vitin 2002 me aktgjykimin e formës së prerë për xxx, në paraburgim prej xxx, ku vazhdon të jete edhe tani;

Në përputhje me aktgjykimin e shkallës së parë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në lëndën me numër P. Nr. 46/10 të datës 13 korrik 2011 të regjistruar në shkrimoren e

Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në të njëjtën ditë, **i pandehuri u shpall fajtor për veprat penale në vijim:**

[i] sepse më 17 shtator 2010 rreth orës 07:00, në fshatin xxx, Komuna e Skenderajt, në afërsi të stacionit të autobusit afër pompës së karburanteve “xxx”, i akuzuari qëllloi me dashje me pistoletën e tij – TT M57 të kalibrit 7,62 mm – së paku pesë herë në palën e dëmtuar B.O., xxx, duke i shkaktuar lëndime të rënda në krahun e djathtë, këmbën e djathtë, këmbën e majtë dhe nyjën e këmbës së majtë. Në ditën kritike pala e dëmtuar ishte duke udhëtuar në drejtim të Mitrovicës me veturë zyrtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës bashkë me kolegët e tij S.G., R.R. dhe vozitësin B.T.. S.G. dhe R.R. ishin në ulëset e prapme të veturës, kurse B.O. ishte në ulësen e përparme në anën e bashkudhëtarit. Kur arritën te stacioni i lartpërmendur i autobusit, i akuzuari, po ashtu anëtar i xxx, ngriti dorën e tij për ta ndalur veturën. Kur vetura u ndal rreth 20-30 metra pas të akuzuarit, B.T. doli nga vetura për ta pyetur të akuzuarin pse bëri me shenjë për të ndalur. Tre bashkudhëtarët e tjerë mbetën në veturë. I akuzuari i tha T. se donte të bisedonte shkurtazi me Komandantin O. Gjersa vozitësi kthehej te vetura dhe ishte në momentin e hyrjes në ulësen e vozitësit, i akuzuari shkoi drejt anës së djathtë të veturës, e hapi derën e ulëses së përparme të bashkudhëtarit dhe e pyeti B.O.n “pse e ke hequr fotografinë?” Më vonë është bërë e qartë se bëhej fjalë për fotografinë e xxx, e cila pak kohë para incidentit ishte hequr nga zyra ku i akuzuari punonte, në bazën e xxx në Mitrovicë. I akuzuari, menjëherë pasi e bëri këtë pyetje, gjersa qëndronte jashtë veturës në një distancë shumë të vogël nga pala e dëmtuar, nxori pistoletën e tij dhe filloi të qëllonte brenda veturës në drejtim të këmbëve të palës së dëmtuar. Pas të shtënave i akuzuari u largua nga vendi i ngjarjes dhe shkoi në drejtim të fshatit Polac. Për shkak të plagëve të pësura, pala e dëmtuar iu nënshtrua disa intervenimeve kirurgjike dhe, deri më sot, ende nuk e ka përfunduar trajtimin mjekësor, i cili do të merr edhe disa muaj rehabilitim dhe trajtim. Lëndimet e shkaktuara ndaj palës së dëmtuar ishin aq të rënda sa kanë rezultuar me dobësimin e përhershëm të gjymtyrëve të tij dhe zvogëlimin e përhershëm të kapacitetit të tij për punë.

Me këtë veprim, **Sh.K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, paragrafin (1), pikat 10, 20 dhe 40 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

[ii] sepse gjete një periudhe të panjohur kohore deri më 17 shtator 2010, ishte në posedim të paautorizuar të pistoletës TT M57 të kalibrit 7,62 mm, të cilën ai e ka përdorur në mënyrën e përshtatur më lart.

Me këtë veprim, i akuzuari **Sh.K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafin (2) të KPK-së.

Prandaj, i pandehuri **Sh.K.** u dënua me pesë (5) vjet burgim për vepër penale Lëndim i rëndë trupor dhe me tri (3) vjet burgim për vepër penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, prej të cilave Gjykata e Qarkut

nxori një dënim unik me shtatë (7) vjet burgim në përputhje me nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 pikën 2 të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim prej 17 shtatorit 2010 deri më 20 dhjetor 2010 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 21 dhjetorit 2010 deri më 13 korrik 2011 janë llogaritur në dënimin e shqiptuar përputhje me nenin 73 paragrafin 1 të KPK-së.

Pistoleta TT M57 e kalibrit 7,62 mm, me numër serik C-54316 është konfiskuar në përputhje me nenin 60 paragrafin 1 dhe nenin 328 paragrafin 5 të KPK-së.

I pandehuri është detyruar t'i mbulojë shpenzimet e procedurës penale përputhje me nenin 102 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit dhe interpretimit.

Padia pronësore e palës së dëmtuar është referuar për procedurë civile sipas nenit 112 paragrafit 2 të KPPK-së.

Avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** brenda fatit kohor ushtroi ankesë më 03 dhjetor 2011 kundër aktgjykimit. Në ankesë pohohet se aktgjykimi përmban shkelje të kodit penal dhe dënimi i shqiptuar kundër të akuzuarit duhet të kundërshtohet. Është propozuar të *“ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar me gjetjet se veprimet e të pandehurit Sh.K. përmbajnë elemente të veprës penale Lëndim i rëndë trupor, neni 154 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 pikën 2 dhe 4 të KPK-së, ose në rastin më të pafavorshëm të shqiptohet një dënim më i lehtë për veprën e njëjtë penale, neni 154 paragrafi 1 pika 2 dhe 4 e KPK-së dhe veprën penale të përshkruar nën Pikën 2 të aktgjykimit”*.

Prokurori Publik i Qarkut të Mitrovicës po ashtu brenda afatit kohor ushtroi ankesë me shkrim kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut më 06 dhjetor 2011 të regjistruar në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë më 08 dhjetor 2011. Në ankesë pohohet se aktgjykimi përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në përputhje me nenin 405 të KPPK-së dhe shkelje të kodit penal në përputhje me nenin 404 të KPPK-së. Propozohet që *“aktgjykimi për Lëndim të rëndë trupor të anulohet dhe të zëvendësohet me një aktgjykim për Vrasje të rëndë në tentativë”*.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar brenda afatit kohor ushtroi ankesë më 03 dhjetor 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe pohoi se dënimi i shqiptuar kundër të pandehurit nuk ishte mjaft i ashpër, duke marrë parasysh pasojat e rënda të krimit dhe në veçanti invaliditetin e përhershëm të palës së dëmtuar si pasojë e të shtënave.

Avokati mbrojtës i të pandehurit, si edhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar u përgjigjen në ankesat përkatëse të palës tjetër.

ZPShK me një përgjigje të datës 24 maj 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më datë 25 maj 2012 plotësisht mbështeti Prokurorin e Qarkut në Mitrovicë dhe propozoi që e njëjta të miratohet nga Gjykata Supreme e Kosovës. Është pohuar se aktgjykimi i kundërshtuar përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Është propozuar të modifikohet aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut dhe i pandehuri **Sh.K.** të dënohet për akuzat për Vrasje e Rëndë në Tentativë në pajtueshmëri me Nenin 147 pika 4 në lidhje me Nenin 20 të KPK-së, por të refuzohet si të pabazuar ankesa e të pandehurit dhe

mbrojtësit të tij dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në pjesët e tij të mbetura.

Bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën P. Nr. 46/10 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të datës 13 korrik 2011, ankesën e paraqitur me shkrim nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës, ankesën e palës së dëmtuar të paraqitur përmes përfaqësuesit të tij ligjor, si dhe ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë dhe Mendimin e ZPSHK, shkresat përkatës të lëndës dhe parashtrirat gojore të palëve gjatë seancës më 17 korrik 2012, së bashku me një analizë të ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimeve më 17 korrik 2012, me anë të kësaj lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e Prokurorit të Qarkut në Mitrovicë dhe ankesa e ushtruar në emër të palës së dëmtuar kundër aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P. Nr. 46/2010, të datës 13 korrik 2011, PRANOHEN.

Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit PJESËRISHT PRANOHET.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë MODIFIKOHET me sa vijon:

Vepra penale ri – cilësohet si Vrasje në Tentativë në pajtueshmëri me Nenin 146 në lidhje me Nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

I pandehuri dënohet me:

- gjashtë (6) vjet burgim për veprën penale Vrasje në Tentativë në pajtueshmëri me Nenin 146 në lidhje me Nenin 20 të KPK dhe
- dy (2) vjet burgim për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo përdorim të Armëve në pajtueshmëri me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK.

Dënimi unik përcaktohet me shtatë (7) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2 të KPK.

Në dënimin e shqiptuar llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

Më 19 tetor 2010 është ngritur Aktakuza (PP. nr. 114/2010) nga ana e Prokurorit të Qarkut në Mitrovicë, e cila është konfirmuar në tërësi nga gjyqtari për konfirmim të aktakuzës më 19 nëntor 2010.

Shqyrtimi gjyqësor filloi përmes, në tërësi, pesë seancave më 04, 05, 06, 08 dhe 13 korrik 2011, kur në të fundit është shpallur aktgjykimi i kundërshtuar.

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri është marrë në pyetje më 04 korrik 2011 dhe ka pranuar fajësinë për akuzën nën Nenin 328 paragrafi 2 të KPK. Për më tepër, janë dëgjuar pala e dëmtuar **B.O.** (04 korrik 2011) si edhe dëshmitarët R.R., S.G. (04 korrik 2011), B.T., H.B. (05 korrik 2011) dhe eksperti Dr. A.Xh. (06 korrik 2011).

Përveç kësaj, dokumentet në vijim janë lexuar në procesverbal: Raporti i policit 2010-BF-0559 i datës 17 shtator 2010, Raporti i vendit të ngjarjes 2010-BF-0559 i datës 17 shtator 2010, albumi i fotografive dhe skica nga vendi i ngjarjes e përfshirë në shkresat e lëndës; raporti mjekësor nga Qendra Mjekësore në Skenderaj në emër të **B.O.** me nr. 1211 i datës 17 shtator 2011 nga Dr. Z.D., shkresat e lëndës në emër të **Sh.K.** të përfshira po ashtu në shkresat e lëndës. Për më tepër, kolegjit i është paraqitur Prova nr. 1, që është koka e plumbit e që, sipas palës së dëmtuar, është nxjerr nga këmba e tij në spitalin ushtarak Turk.

Avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** në kohë ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit më datë 03 dhjetor 2011 ku pohoi dhe propozoi që veprimet e të pandehurit **Sh.K.** të ricilësohen si Lëndime të Rënda Trupore në pajtueshmëri me Nenin 154 paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 pika 2 dhe 4 të KPK, apo në rastin më të pa volitshëm të shqiptohet një dënim i të butë sikurse u definua më parë.

Prokurori i Qarkut në Mitrovicë po ashtu në kohë ka ankimuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut me një ankesë me shkrim të datës 06 dhjetor 2011 në të cilën pohoi dhe propozoi *“që aktgjykimi për Lëndime të Rënda Trupore të prishet dhe zëvendësohet me aktgjykimin për Vrasje e Rëndë në Tentativë”* sikurse është definuar më parë.

Përfaqësuesi Ligjor i palës së dëmtuar në kohë ka ushtruar ankesë më datë 03 dhjetor 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe pohoi se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nuk ishte i ashpër sa duhet, sikurse edhe u definua më lart.

Avokati mbrojtës i të pandehurit e gjithashtu edhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar janë përgjigjur në ankesat përkatëse të palës tjetër.

ZPShK me përgjigjen e datës 24 maj 2012 plotësisht ka mbështetur ankesën e Prokurorit të Qarkut në Mitrovicë dhe ka propozuar që ajo të miratohet nga Gjykata Supreme e Kosovës.

GJETJET E GJYKATËS

A. Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Prokurori i Qarkut në Mitrovicë i mbështetur nga ZPShK ka kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për vërtetim të supozuar të jetë i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sepse Gjykata e Qarkut nuk e ka vlerësuar si duhet dashjen e të pandehurit, kur ai ka shtënë në palën e dëmtuar. Gjykata e Qarkut nuk e kishte vlerësuar tërësisht faktin se i pandehuri nuk ka shtënë vetëm në këmbët e palës së dëmtuar, por edhe në pjesën e sipërme të trupit të tij, veçanërisht në pjesën e sipërme të krahut të tij të djathtë dhe se ai - nga një distancë shumë e afërt - ka shtënë disa herë. Kjo vetëm duhet ta ketë shtyrë Gjykatën e Qarkut në përfundimin se i pandehuri të paktën eventualisht ka dashur ta vras palën e dëmtuar, duke pasur parasysh gjithashtu se në Gjykatë nuk është paraqitur asnjë mendim i pranueshëm mjekësorë me të cilin thuhet se të shtënat e plumbave në pjesët e poshtme të trupit të njeriut nuk mund ta vrasin atë person. Përveç kësaj, intervista e të pandehurit e dhënë në polici do të ofrojë prova të mjaftueshme për dashjen e tij për të vrarë, sepse në këtë rast ai kishte pohuar se ai ishte duke vepruar në vetëmbrojtje, ndërsa gjatë gjykimin ai kishte mbrojtur veten në heshtje.

Gjykata Supreme e Kosovës pas diskutimeve intensive, ka arritur në mendimin se Gjykata e Qarkut në të vërtetë ka gabuar kur ka vlerësuar se aktivitetet e gjuajtjes së lartë përmendur të të pandehurit shpjen në konkluzionin se i pandehuri ka pasur qëllimin të lëndoj palën e dëmtuar. Përkundrazi, Gjykata Supreme konstaton se incidenti i gjuajtjes qartë tregon dashjen e të pandehurit –në formë të *dolus eventualis* – që të vras edhe palën e dëmtuar. Në pajtueshmëri me Nenin 15 paragrafi 3 të KPK *kryerësi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimin ose i mosveprimin të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj*. Të gjithë dëshmitarët e incidentit përfshirë palën e dëmtuar kanë dëshmuar para Gjykatës dhe kolegji ka analizuar deklaratat e tyre me kujdes. Në këtë kontekst doli se të gjithë dëshmitarët e përshkruan situatën me fjalë mjaft të ngjashme, duke deklaruar se i pandehuri kishte hapur derën e përparme të automjetit në anën e udhëtarit dhe e pyeti palën e dëmtuar, pse ai e kishte "hequr fotografën" dhe se pas kësaj pyetje ai menjëherë e kishte nxjerr revolen e tij, ishte larguar pak dhe kishte qëlluar në palën e dëmtuar disa herë. Në mënyrë të veçantë vet pala e dëmtuar si edhe dëshmitarët R.R. dhe B.T. kanë theksuar se i pandehuri ka shtënë në këmbët e B.O. Përderisa palës së dëmtuar i kujtohet vetëm që në fund të shtënave revolja 'ka mbetur e hapur', nga e cila ai përfundoi që të gjithë plumbat nga gëzhojat janë shkrepur, dëshmitarët R.R. dhe S.G. i kanë njehsuar gjashtë apo shtatë të shtëna dhe dëshmitari B.T. i ka dëgjuar pesë deri në gjashtë të shtëna.

Pasi që ishte e pamundur të përcaktohet me siguri se sa plumba janë shkrepur në palën e dëmtuar, Gjykata e Qarkut i ka bazuar të gjetura e tyre në numrin minimal të pesë plumbave të njehur nga të gjithë dëshmitarët. Gjykata e Qarkut në mënyrë të plotë i ka analizuar të gjitha deklaratat e dhëna të dëshmitarëve, në mënyrë individuale si dhe të përgjithshme. Numri i së paku pesë plumbave që janë shkrepur në viktimën B.O. gjithashtu përputhet me deklaratën e parë të palës së dëmtuar të dhënë para policisë më 29 shtator 2011. Arsyetim i detajuar është ofruar, pse gjykata nuk e ka ndjekur versionin e palës së dëmtuar që është dhënë para gjykatës gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 4

korrik 2011, sipas të cilës ai gjoja se është qëlluar nga tetë plumba (fq.10 e aktgjykimit të atakuar në versionin e gjuhën angleze).

Veç kësaj, dëshmitari H.B. është dëgjuar, i cili e shkroi ‘Raportin e ekzaminimit të veturës’ të datës 19 shtator 2010. Dëshmitari, bazuar në raportin e tij dhe në fotografitë ka deklaruar që distanca në mes të pandehurit dhe të palës së dëmtuar gjatë të shtënave ishte afro një metër e pesëdhjetë centimetra (1.5 m) dhe nuk janë gjetur vrima të plumbave mbi ulësen ku gjoksi normalisht është i pozicionuar. (Në këtë sfond, deklarata e Gjykatës së Qarkut, sipas së cilës distanca në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar gjatë të shtënave ka qenë më pak se një metër [fq.10 e aktgjykimit të atakuar në versionin e gjuhës angleze] është kuptuar të jetë gabim shtypi).

Gjykata e Qarkut e ka bazuar vlerësimin e saj sipas këtyre provave të gjetura “*që i pandehuri ka pasur synim këmbët e palës së dëmtuar është dëshmuar: nga dëshmia e znj. R dhe z. T; nga gjetjet e ‘Raportit të ekzaminimit të veturës’, të datës 19 shtator 2010, dhe e vërtetuar [...] nga eksperti dëshmitarë z. B. [...] i cili theksoi...* që asnjë vrimë e plumbave nuk është gjetur mbi ulëse ku normalisht gjoksi është i pozicionuar; dhe përfundimisht nga fakti që pala e dëmtuar është qëlluar nga plumbat në këmbën e tij dhe në parakrahun e djathtë, e që sipas të gjitha dëshmimeve, ishte duke qëndruar përgjatë trupit të tij” (fq.9 e aktgjykimit të atakuar në gjuhën angleze).

Megjithatë, Gjykata e Qarkut nuk ka arritur të marr në konsideratë të mjaftueshme që gjithashtu sipas raportit mjekësorë të Qendrës Rehabilituese të Forcave të Armatosura Turke në Ankara, të datës 24 mars 2011, ndërhyrja kirurgjike është kryer në parakrahun e djathtë për degët e “*arteries ulnare radiale ndërmjet eshtrave*”, për shkak të faktit që një prej plumbave të shkrepur ka shkuar nëpërmes krahut të djathtë të palës së dëmtuar tek këmba e tij dhe i ka lënduar arterien aty.

Përderisa, gjykata pranon pohimin e të pandehurit që ai ka synuar vetëm pjesët e gjymtyrëve të poshtme të trupit të viktimës me qëllim të shmangies plagët që kërcënojnë jetën, përfundon që veprim i tillë nuk mundet në asnjë mënyrë të jetë i mjaftueshëm për të eliminuar mundësinë e plagës vdekjeprurëse duke marr parasysht mënyrën se si është ekzekutuar e shtëna. I pandehuri, duke qenë xxx dhe i trajnuar në përdorimin e armëve të dorës, duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për faktin që revolja se si është përdorur nga ai është armë shumë jo precize dhe mund të shkaktoj plagë tjera se sa ato që janë synuar për shkak të zbrapsjes së shumë të fortë dhe të rezultatit të pasaktësisë të qëllimit në të shtënën e ardhshme. Prandaj, ai duhet ta kishte marr parasysht mundësinë e plagosjes së viktimës në atë mënyrë që seriozisht do të rrezikonte apo të ishte fatale për jetën e tij. Viktima në pozitën e ulur në veturë paraqiste një cak shumë më të vogël se sa pësoni i cili qëndron duke qëndruar në këmbë dhe si pasojë ka qenë edhe më vështirë shmangja e qëllimit të organeve vitale të trupit. Pjesa e sipërme e këmbëve dhe zona e legenit – regjioni i trupit, të cilin i pandehuri ka pasur qëllim në të shtënat e tij – përmban enë të mëdha të gjakut, të cilat kur të merr plagë shkaktojnë gjakderdhje të rëndë, që shpie në vdekje brenda një periudhe të shkurtë kohore. Përveç kësaj, është vërtetuar që i pandehuri ka qëlluar së paku pesë herë në një seri të shpejtë pa pasur kohë të mjaftueshme për të korrigjuar synimin e tij. Përderisa nuk ka qenë domosdoshmërisht qëllimi i tij primar për

të vrarë B.O.n, i pandehuri me siguri ka qenë i vetëdijshëm që veprimet e tij përfundimisht do të shkaktonin vdekjen e viktimës. Megjithatë, ai e ekzekutoi planin e tij pa marr parasysh pasojat e mundshme. Bazuar në këtë, gjykata e sheh si të dëshmuar përtej dyshimit të bazuar që i pandehuri e ka parashikuar mundësinë e vrasjes së viktimës së tij por me vetëdije e ka marr rrezikun që prapëseprapë të ekzekutoj planin e tij. E gjithë kjo shpie në konkluzionin e fortë që ai ishte duke vepruar së paku me qëllimin eventual për të vrarë.

Si rezultat, vërtetim i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është përcaktuar në lëndën në fjalë dhe është bërë shkelje e nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së.

B. Shkelja substanciale e Ligjit Penal

Prokurori i Qarkut në Mitrovicë i mbështetur nga ZPShK-ja e gjithashtu nga avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** ka atakuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për shkelje të pretenduara të Kodit Penal.

Prokurori i Qarkut dhe ZPShK-ja janë të mendimit që vlerësimi i duhur i provave nga Gjykata e Qarkut, do ta mund të shpinte gjykatën të shpall të pandehurin fajtorë për Vrasje të Rëndë në Tentativë në pajtim me nenin 147 pikës 4 e lidhur me nenin 20 të KPK-së. Në veçanti ata i referohen faktit që i pandehuri nuk ka shtënë vetëm në këmbë të palës së dëmtuar por gjithashtu në pjesën e sipërme të trupit të tij, që ekziston kontradiktë në mes të deklaratës së pandehurit para policisë ku ai ka pohuar që ka vepruar në vetëmbrojtje (përderisa duke e mbrojtur veten në heshtje para gjykatës) dhe që ai ka shtënë së paku pesë por duket më tepër që ka shtënë tetë herë kundër viktimës duke e zbratur tërë karikatorin e revoles së tij.

Në të kundërtën, avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** ka theksuar që Gjykata e Qarkut nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme faktit që i pandehuri gjithmonë ka pasur marrëdhënie të mira me palën e dëmtuar dhe që largimi i fotografisë së xxx, i cili ishte idhull për atë, nga zyra e tij ka shkaktuar çrregullim të veçantë mental në të. Prandaj, Gjykata e Qarkut si rezultat i vlerësimit të duhur të të gjitha fakteve do të duhej të arrij të i cilësojë veprimet e të pandehurit **Sh.K.** si vepër penale në pajtim me nenin 154 paragrafit 6 të KPK-së.

Gjykata Supreme arriti tek mendimi që gjetjet faktike të Gjykatës së Qarkut siç janë vërtetuar më parë nuk lënë hapësirë për cilësimin e veprimit të pandehurit si Lëndim i Rëndë Truporë në pajtim me nenin 154, paragrafin 1 të KPK-së, por që – edhe pse kërkesat e Vrasjes së Rëndë në Tentativë sipas nenit 147 pikës 4 të KPK-së siç është propozuar nga prokuroria nuk janë përmbushur – incidenti duhet të cilësohet si Vrasje në Tentativë në pajtim me nenin 146 të KPK-së.

Neni 147 pika 4 e KPK-së nuk është e aplikueshme në lëndën në fjalë, për shkak se dispozita përcakton si në vijim:

Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:

4) *Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave.*

Duhet të nënvizohet që në lëndën në fjalë në asnjë kohë asnjë person tjetër përveç palës së dëmtuar nuk kanë qenë të rrezikuar gjatë të shtënave.

Të gjithë dëshmitarët e menjëhershëm të incidentit – aq sa kanë parë të pandehurin ku ai ishte duke e drejtuar revolen e tij – në mënyrë të përsëritur dhe në mënyrë të padiskutueshme kanë deklaruar që i pandehuri pasi që i ka thënë vozitësit, dëshmitarit B.T. që ai duhej të fliste me palën e dëmtuar në cilësinë e tij si komandant i FSK-së, shkoi në pjesën e djathtë të veturës, ku pala e dëmtuar B.O. ishte i ulur në ulësen e pasagjerit në pjesën e përparme, që ai ka hapur derën, ka bërë pyetjen e tij lidhur me largimin e fotografisë dhe filloi menjëherë të qëlloj në palën e dëmtuar. Në veçanti, dëshmitari B.T. në deklaratën e tij në polici të datës 22 shtator 2010 dhe para gjykatës në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 5 korrik 2011 ka vënë në pah që i pandehuri e ka drejtuar armën e tij në drejtim të këmbëve/shputave të palës së dëmtuar dhe dëshmitarja R.R. ka deklaruar para gjykatës më 5 korrik 2011 që i pandehuri e ka drejtuar armën në pjesën e poshtme të trupit të viktimës. Të dy provat janë vërtetuar me deklaratën e vetë palës së dëmtuar, që i është dhënë policisë më 23 shtator 2010 dhe para gjykatës më 4 korrik 2011, sipas së cilës ai ishte qëlluar me së paku dy plumba, në këmbën e djathtë dhe në këmbën e majtë dhe që ai ka marr plagë në parakrahun e tij të djathtë (të cilat sipas gjetjeve të Gjykatës së Qarkut ishte shkaktuar nga fakti që pala e dëmtuar e ka mbajtur krahun e djathtë të tij në linjë me këmbën e tij, kur kanë filluar të shtënat). Për më tepër, si rezultat i ‘Raportit ekzaminues të veturës’ të datës 19 shtator 2010 dhe i përgatitur nga polici mjeko-ligjorë H.B., i cili theksoi që si ekspert dëshmitarë para gjykatës më 5 korrik 2011, është gjetur që ulësja e përparme e pasagjerit në veturë, ku pala e dëmtuar ishte ulur gjatë të shtënave tregonte dy vrima të plumbave, që ishin shkaktuar nga pothuajse të shtënat pingule.

Mbi këtë sfond duhet të përfundohet që në asnjë kohë nuk ka ekzistuar rrezik objektiv dhe konkret për pasagjerët tjerë të veturës, bile duke marr parasysh faktin që sipas deklaratës së dëshmitarit S.G. që është dhënë në polici më 22 shtator 2010 dëshmitarët B.T., R.R. dhe S.G. *“menjëherë [...] kanë zbritur nga vetura pasi që [ata] gjithashtu janë ndjerë të rrezikuar pasi që i njëjti gjithashtu e ka drejtuar armën e tij në drejtim të [tyre]”*. Në asnjë kohë i pandehuri nuk ka shtënë armën e tij derisa e drejtonte armën në asnjë vend tjetër se sa në drejtim të këmbëve të palës së dëmtuar. Drejtimi i revoles në drejtim të udhëtarëve të tjerë pa shtënë në ta nuk cilësohet si rrezik konkret ndaj jetës së tyre në kuptim të nenit 147 paragrafit 4 të KPK-së.

Madje edhe nëse dikush merr qëndrimin se i pandehuri ka shkaktuar rrezik real dhe konkret ndaj jetës së udhëtarëve të tjerë, nuk ka indikacione se ai ka pasur për qëllim që të shkaktoj një rrezik të tillë. Në mënyrë që të aplikohet cilësimi nga neni 147 pika 4 e KPK-së kërkohet që përshkrimi i rrethanave cilësuese - rrezikimi i jetës së një apo më tepër personave – të përfshihet në qëllimin e kryerësit. Ai së paku do të duhej të kishte qëllim në lidhje me këtë, siç parashihet në nenin 15 paragrafin 3 të KPK-së.

Këtu grindja e të pandehurit ka qenë vetëm me palën e dëmtuar B.O. dhe nuk ka asnjë provë se ai ka dashur ose madje vetëm ka miratuar rrezikimin e jetës së udhëtarëve të tjerë.

Si rezultat, Gjykata Supreme gjen se në këtë lëndë të gjitha kushtet objektive dhe subjektive të Vrasjes në tentativë sipas nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së ekzistojnë, prandaj për këtë arsye vlerësimi i Gjykatës së Qarkut duhet të ri-cilësohet.

Sa i përket pretendimeve të avokatit mbrojtës lidhur me gjendjen e afektit mendor të pretenduar të të pandehurit në kohën kur ai ka kryer krimin, kjo nuk ka ndonjë bazë të duhur në gjetjet e Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës.

Përkundër kësaj, sipas gjetjeve të Gjykatës Supreme vepra penale Shkaktim i lëndimeve të rënda trupore nuk ekziston në këtë rast, **neni 154 i KPK-së** – si nen relevant në lidhje me këtë – përcakton si në vijim:

(1) Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me:

...

Dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

...

(6) Nëse vepra penale nga paragrafët 1, 2 ose 3 të këtij neni kryhet në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së rëndë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e palës së dëmtuar, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

Nuk është paraqitur asnjë indikacion se largimi i fotografisë së xxx nga zyra ku i pandehuri ishte duke qëndruar ka mundur t'i shkaktoj atij gjendjen e afektit mendor si shok i rëndë i shkaktuar nga një sulm, keqtrajtimit ose fyerje e rëndë nga pala e dëmtuar siç supozohet me ligj. Përkundrazi, largimi i fotografisë – e cila në asnjë moment nuk është diskutuar nga i pandehuri ose me kolegët e tij ose me të palën e dëmtuar më parë – duket të jetë motivim gati qesharak për kryerjen e veprës penale në fjalë, duke i shkaktuar viktimit probleme shëndetësore të rënda dhe permanente. Gjithashtu, pretendimi i mbrojtjes i paraqitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 17 korrik 2012, sipas të cilit afekti mendor i të pandehurit ka rrënjët në përvojën e tij të dhimbshme dhe të rëndë nga koha e luftës kur ka qenë ushtar i UÇK-së dhe me ç' rast ai ka humbur babanë dhe vëllain e tij, nuk kanë mbështetje të mëtutjeshme e as nuk mundet ky shkaktar i gjendjes së afektit mendor të cilësohet si njëra nga rrethanat e përmendura në nenin 154 paragrafin 6 të KPK-së ('...i shkaktuar nga një sulm, keqtrajtimi ose fyerja e rëndë nga pala e dëmtuar ...').

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet përkatëse të avokatit mbrojtës janë pa merita dhe të pabazuara.

C. Vendimi mbi dënimin

Avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** si dhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar kanë theksuar se vendimi mbi dënimin është i padrejtë, përderisa avokati mbrojtës i të pandehurit **Sh.K.** është i mendimit se dënimi i shqiptuar është tepër i ashpër, duke pasur parasysh se është shqiptuar dënimi më i lartë i mundshëm për veprën penale Lëndime të rënda trupore, duke mos marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme efektin emocional të largimit të fotografisë së xxx që ka pasur në të pandehurin **Sh.K.** si dhe faktin se pala e dëmtuar gradualisht është duke e marrë vetën. Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar ka theksuar se si rezultat i të shtënave pala e dëmtuar ka mbetur invalid i përhershëm, për këtë arsye dënimi është tepër i butë.

Vendimi mbi dënimin duhej të shqyrtohej gjithashtu për shkak të ri-cilësimit të incidentit të shtënies si Vrasje në tentativë sipas nenit 146 të KPK-së dhe - në prapavijë të ankesës siç është paraqitur nga mbrojtja – gjithashtu në lidhje me veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

Gjykata Supreme ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese në lidhje me të pandehurin **Sh.K.** dhe aktivitetet e tij.

Megjithatë, në lidhje me veprën penale Vrasje në tentativë sipas nenit 146 të KPK-së, kërkohet që të ri-definohet dënimi i veçantë në pajtim me kornizën e ndryshme ligjore mbi dënimin në krahasim me dënimin e mëparshëm për Lëndime të rënda trupore. Duke pasur parasysh dhimbjen e pamasë dhe pasojat e rënda të të shtënave për viktimën si dhe faktin se i pandehuri nuk ka shtënë vetëm një herë por së paku pesë herë, kështu duke e shtuar rrezikun e veprimit të tij për jetën dhe shëndetin e palës së dëmtuar, Gjykata Supreme e konsideron dënimin e veçantë prej gjashtë (6) viteve si të balancuar dhe në pajtim me peshën e krimit.

Sa i përket dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, Gjykata Supreme dënimi i veçantë prej tre (3) viteve është pak i tepërt duke pasur parasysh praktikën e dënimit të miratuar nga Gjykatat e Kosovës për raste të ngjashme. Prandaj, duke pasur parasysh situatën specifike të kësaj lënde siç tanimë është shtjelluar nga Gjykata e Qarkut, Gjykata Supreme e konsideron dënimin e veçantë prej dy (2) viteve si adekuat.

Në bazë të dy dënimeve të ndara, një dënim unik prej shtatë (7) viteve burgim është arritur në pajtim me nenin 71 të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak duhet të llogaritet sipas nenit 73 paragrafit 1 të KPK-së.

Gjithashtu, duke marrë parasysh nivelin e rrezikut shoqëror të kryerjes së veprave penale si dhe nivelin e përgjegjësisë së të akuzuarit, të fundit i është shqiptuar një dënim unik i drejtë.

Për arsye të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Anëtarët e kolegjit:

Francesco Florit
Gjyqtar i EULEX-it

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap.-Kž. Nr. 21/2012
Prishtinë
17 korrik 2012